

Autoriteti 2014  
konkurrencës  
Austriak

**Memorandum Bashkëpunimi  
Ne Fushën e Politikës së Konkurrencës**

**midis**

**Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës**

**dhe**

**Autoritetit Federal Austriak të Konkurrencës**

Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës dhe Autoriteti Federal Austriak i Konkurrencës (këtu e më poshtë referuar si "Palët");

Duke shprehur dëshirën për të nxitur bashkëpunimin në fushën e politikës së konkurrencës dhe zbatimit të ligjit të konkurrencës;

Duke synuar krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe;

Bazuar në parimet e barazisë dhe përfitimit të ndërsjellët;

Duke nënvizuar rolin e konkurrencës në zhvillimin real dhe efektiv të ekonomisë së tregut;

Kanë rënë dakord si vijon:

**Neni I**

Palët do të nxisin dhe forcojnë bashkëpunimin në zbatim të ligjit dhe politikës së konkurrencës, në përputhje me legjisllacionin kombëtar të Shteteve të Palëve.

**Neni II**

Në interes të ndërsjellë të Palëve, bashkëpunimi do të realizohet në drejtimet themelore të mëposhtme:

- a) Shkëmbimi i informacionit mbi zhvillimet legjisllative;
- b) Shkëmbimi i eksperiencës në fushën e hetimeve në lidhje me shkeljen e rregullave të konkurrencës, duke respektuar dispozitat e kuadrit ligjor përkatës në fuqi në të dy vendet;
- c) Shkëmbimi i përvojës me marrëdhëniet midis autoriteteve të

konkurrencës dhe agjencie rregullatorë kombëtare.

### **Neni III**

Format kryesore të ndërveprimit të palëve mund të jenë si vijon:

- a) Shkëmbimi i informacionit jo-konfidenciale lidhur me zhvillimet legjislative dhe rastet hetimore;
- b) Organizimi i vizitave studimore dhe trajnime me eksperte;
- c) Pjesëmarrja në konferenca, simpoziumeve, seminareve dhe aktiviteteve të tjera të organizuara nga palët;
- d) Takimet e ekspertëve apo konsultimi me anë të e-mail mes ekspertëve të Palëve që sigurojnë shkëmbim të informacionit jo-konfidencial mbi çështje të veçanta me interes të përbashkët;
- e) Organizimi i takimeve të nivelit të lartë / vizitave për të diskutuar perspektivat dhe drejtimit në të cilat do të vazhdojë bashkëpunimi dypalësh;
- f) Shkëmbimi i dokumenteve, studimeve, librave etj, të cilat janë botuar nga Palët.
- g)

### **Neni IV**

Transferimi i informacionit do të zhvillohet në gjuhën angleze me postë / e-mail përmes pikave të përcaktuara të kontaktit ose me anë të takimeve të përfaqësuesve të palëve.

### **Neni V**

Agjenda e aktiviteteve, me vendin dhe elemente të tjera, duke përfshirë edhe aspektet financiare, do të përcaktohet individualisht nga Palët me marrëveshje të përbashkët.

### **Neni VI**

Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumit, nëse ka, do të zgjidhen me anë të konsultimeve dhe negociatave.

### **Neni VII**

Ky memorandum nuk do të shkelë dhe / ose të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, ku Shtetet e Palëve janë anëtarë.

### **Neni VIII**

Me marrëveshje të përbashkët të Palëve çdo shtesë apo ndryshim mund të bëhet pjesë e këtij Memorandumi, në formën e protokolleve, pjesë përbërëse e Memorandumit.

### **Neni IX**

Ky memorandum nënshkruhet për një periudhë të pakufizuar kohe dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.

### **Neni X**

Memorandumi mund të përfundojë me një njoftim me shkrim nga secila Palë drejtuar Palës tjetër.

Memorandumi do të shfuqizohet pas tre muajve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim mbi përfundimin e këtij Memorandumi.

### **Neni XI**

Ky memorandum u firmos në Vjenë në 12 Dhjetor 2014 në dy kopje identike, nga një për secilën palë.

**Për Autoritetin  
Shqiptar te Konkurrencës**

Lindita Milo (Lati)  
Kryetare

**Për Autoritetin  
Federal Austriak të Konkurrencës**

Theodor Thanner  
Drejtor i Përgjithshëm